

URDHËR
Nr. 656, datë 4.7.2025

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 397, DATË 23.4.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË” DHE PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 46, DATË 17.1.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e:
 - urdhrit nr. 397, datë 23.4.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Hungarisë”;
 - urdhrit nr. 46, datë 17.1.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”.
 2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj